





Pushime të paharrueshme verore për fëmijët e komunitetit

Elsi, Enisi, Edina dhe fëmijët e tjerë falenderojnë "Motrat Qiriaz" për pushimet e bukura verore që iu dhuruan

Shkruar nga Elmira Muja

Për më shumë se 130 vite, Fresh Air Fund u ka dhuruar fëmijëve të New York-ut, një verë të bukur, me te gjitha dimensionet e një argëtimi të këndshëm, mbushur plot me aventura dhe kujtime., iu ka ofruar gjithashtu një mundësi të re, duke iu hapur një botë që, ndryshe ndoshta nuk do ta njihnin kurrë. Larg nga ajri i mbytur i qytetit në një botë magjike me qiell të ndritshëm dhe me gjelbërimin e tejskajshëm dhe të freskët, ajrit të pastër mbushur me cicërimat e zogjve.

Hareja e notit, biçikletave dhe piknikëve shtohet akoma më shumë kur e ndan atë me miq të rinj. Fëmijët vizitojnë familjet mikpritëse vullnetare në veri-perëndim ose kalojnë netë në kampe verore. .

Kur mbaron shkolla fëmijët e etur për pushime të bukura parashikojnë ritet e gëzueshme të verës; kampet verore, hipur mbi

biçikletë, dhe barbeques në oborrin e shtëpisë, dhe shumë prej tyre presin diçka të re për të shijuar.

Fëmijët e "Ajrit të Pastër" po kalojnë pushimet në pesë kampet e Fondacionit "Ajri i Pastër", vendosur në Fishkill, New York. Për here të pare, këtë vit Fondacioni i Ajrit të Pastër u siguroi fëmijëve pushime në Cayman Island.

KAMPI DHE JETA BRENDA TUJ

Falë bashkëpunimit 2 vjeçar me Fresh Air Fund, organizata e gruas shqiptaro-amerikane "Motrat Qiriaz", bëri të mundur që shumë fëmijë të komunitetit tonë të kalojnë pushimet verore falas.

Për shumicën e fëmijëve, kampi është kamp-ata nuk mendojnë rreth aftësive ata janë duke mësuar për të ardhmen, ose për t'u bërë njerëz të vyer. Ata janë duke shijuar dhe iu gëzuar përvojës së re, krejt e ndryshme nga ajo në shtëpi apo në

shkollë.

Jeta në kamp u ofon fëmijëve eksperiencën e re, një lidhje ndërmjet teorisë dhe praktikës. Në kamp ata kanë mundësi që të shijojnë lojrat pa kufi, të krijojnë një miqësi të re, të ndajnë me njëri tjetrin gëzimet dhe castet e bukura.

Është viti i dytë që shumë nga fëmijët e komunitetit tonë kanë shijuar pushime të këndshme, ndryshe nga herët e tjera, në një ambient që natyra i ka dhuruar përmes gjelbërimit një magjepsje të rrallë që kemi dëshirë ta kemi cdo ditë.

Aty ku gjelbërimi shtrihet në mijra hektarë rrethuar me kurora të pyjeve liqenet e vegjël janë një bukuri më vete, duke krijuar me të vërtetë një pikturë origjinale.

I ndërtuar mbi bazën e grupmoshave të fëmijëve, kampi u ofron atyre të gjitha përmasat e një shtëpie pushuese.

Të gjithë dëshirojmë që fëmijët

tanë të kenë pushime të gëzuara, larg nga e përditëshmjia.. Cdo vit një objekt i ri i shtohet kampit, kjo gjithnjë sipas kërkesave të fëmijëve për të mësuar diçka më shumë rreth natyrës, atë çfarë ata nuk mund ta kenë në realitet në shkollë dhe rreth saj.

Për Arlind Fejzullai, motrat Milla dhe motrat Pando, Henrin, Leonardin, Vera, Alketi etj, është viti i dytë i pushimeve në kamp.

Këtu në kamp, ne mësojmë shumë gjëra të reja, më thotë Henri. Mësojmë diçka rreth kopshtarisë dhe njohim nga afër kafshët shtëpiake, të cilat i kemi parë vetëm në librat mësimorë. Mbasditet argëtuese me lojra të ndryshme na e bëjnë edhe më të këndshme jetën në kamp. Të gjithëve na pëlqen të notojmë, por në qytet jo të gjithë e kemi këtë mundësi. Këtu në kamp ne mësojmë jo vetëm të notojmë, por mësojmë kopshtarinë, njihemi me gjithcka të bukur që natyra i ka

falur Fishkill-it.

I gjithë ushqimi është ai që pëlqehet nga ne, më thotë Vera. Në mëngjes ne kemi cereal të ftohtë dhe ushqim të ngrohtë, si petulla, bukë të thekur ose waffles. Drekë përfshin hero sandwiche, pica, hot-dog, hamburger, të shoqëruara me patate të skuqura, karrota dhe selino, fruta, sallatë perimesh dhe sallatë makaronash. Darka përfshin pulë të skuqur ose të pjekur, meat-loaf, mish viçi të pjekur, llazanja, dhe mish viçi të zgarës. I gjithë ushqimi është i aprovuar nga Departamenti i Shtetit të Agrikuturës. Të gjithë ne jemi të lirë të zgjedhin vetë sipas dëshirës ushqimin e shërbyer në tavolina.

QYTEZAT MIKE

Eksperiencia shumevjeçare ka bërë të mundur që Fresh Air Fund tu sigurojë fëmijëve të NY pushime të këndshme edhe me programin

Artiste Limousine Service

FOR ALL OCCASIONS & DESTINATIONS
Weddings • Airports • Night Out • Anniversaries
Proms • Casinos • Concerts • Sporting Events

"Weddings & Proms Our Speciality"
 Featuring New Luxurious
 2 - 24 Passengers Super
 Stretch White Lincolns

914.243.0807
www.artistelimo.com
Lule (Lola) & piktori Nua (Tony) Gjokaj

PORTRAIT GALLERY

Open 7 Days
by appointment

Luan Qose
Artist

917.348.9046
qoseluan@hotmail.com

Reklamoni biznesin tuaj në Illyria

Tel: 212.868.2224 | marketing@illyriapress.com



“Qytezat Mike”

Qytezat Mike janë qendrat e rrethinave ose fshatrave ku jetojnë familjet mikpritëse vullnetare. Ato ndodhen në 13 shtete verilindore si dhe në Kanada. Qytetet mikpritëse janë aq larg sa Maine dhe Virginia; dhe po aq afër sa Long Island dhe Westchester.

Elsi, Enis dhe Edina Rama nga Staten Island edhe këtë vit i kaluan pushimet verore në “Qytezat Mike”. Eksperienca ime ne Qytezat Mike është shumë e bukur. Për dy vjet unë shkoj në të njëjtën qytezë tek Kerry dhe Renee Starr në Pennsylvania. Alysa, vajza e tyre është shoqe dhe motër për mua. Dy verat e mia kanë qenë të larmishme dhe me plot aktivitete.

Elsi, ndërsa Enisi ka shumë për të treguar, por nuk di nga tia fillojë. Në Amesbury, Masachusets, unë gjeta një familje të dytë. Pushimet e mia verore ishin më të bukurat që kam patur deri më sot. Gjithnjë do ti kujtoj me respekt dhe dashuri Synthia dhe Benjamin Wigren, për përkushtimin dhe gjithëcka ata bënë për mua. Tashmë edhe ata janë bërë pjesë e familjes sime dhe më pas Enis më tregon albumin e pëgatitur në Amesbury, ku secila faqe me fotot e renditura rrëfen një ditë të jetuar atje.

“Ndryshimi i Qytezave Mike me New York-un është, se hëna nuk shihet dot nga qyteti për shkak të dritave të shumta, por Qyteza Mike e shfaq hënën e plotë!” thotë Alketi..

Elisabeta, Urani dhe Mentori janë ende të vegjël dhe nuk dinë t ë përshkruajnë ditët e bukura që kaluan në “Qytezat Mike”

* * *

Në një ditë korriku, të ftuara nga drejtoresha ekzekutive e Fresh Air Fund, zonja Jenny Morgenthau, një grup i grave të organizatës së gruas shqiptaro-amerikane “Motrat Qiriazit vizitoi kampet dhe rrethinat e tij.

Ndalesa jonë e parë ishte në kampin ABC. Ndërtuar mbi traditën e mikpritjes amerikane, fëmijët me lule dhe me këngë na e uruan mirëseardhjen.

Më pas nën drejtimin e Tim Stanley, ne vizituam të pesë kampet dhe ambientet për rreth tij.

Dy mjedise të reja i janë shtuar kampit këtë vit.

Qendra shkencore dhe ajo e fotografisë. Në aspektin shkencor fëmijët njihen nga afër me shumë elementë të florës dhe faunës dhe evolucionin e botës organike në tërësi.

Ndërkaq njohja me artin e bukur të fotografisë, fëmijët do të mësojnë se sit ë fokusojnë elementë të vecantë të natyrës në aparatin e tyre.

Qendra për “Teen Lidershhip” është një dhuratë nga Sara Siegel-Magness dhe Gary Magness nga Smookewood Music Group, të cilët të frymëzuar nga puna e tyre në

prodhimin e filmit të nominuar për Oskar “E çmuara”, sipas romanit” Push “nga Sapphire, në 2009, Mbështetës për një kohë të gjatë, çifti ka qenë i impresionuar nga puna e Fondi në inkurajimin e vajzave të reja në shtigjet e tyre drejt moshës nadhore. Ky kontribut bujar ka ndihmuar në ndërtimin e qendrës së re me të njejtin titull të filmit” E çmuar” për Teen Leadershipit në kampin ABC të Fondit dhe Fondin e Programit të Teen Leadership, e cila do të udhëheqë vajzat e qyteteve urbane në zhvillimin e aftësive të tyre drejtuese.

Nëpërmjet Programit të ri Teen Leadership, vajzat e reja do të mësojnë të artikulojnë ndjenjat e tyre, e tw kuptojnë pasojat e vendim-marrjes së adoleshentëve dhe të gjejnë se çfarë duan në të ardhmen. Dhe përmes një komponenti letrar, ata do të përmirësojnë leximin dhe aftësitë e komunikimit.

Qendra,u përrua po këtë ditë, ku shiritin e përrimit e preu aktorja e filmit “Precious” Gabourey Sidibe. Ajo është “ vajza e Fresh Air Fund”, më thotë Jenny Morgenthau, drejtoresha ekzekutive. Ajo ende vazhdon te japë kontributin e saj.

Tani ajo sjell më pranë eksperiencën e saj nga kampi dhe jashtë tij.

Një drekë e shijshme së bashku me fëmijët pushues na bëri dhe ne ta ndjejmë me të vërtetë një ditë çlodhëse.



Avokati që i ka përjetuar të njejtat probleme juridike, tani është në dispozicionin tuaj

SABRI (SAM) GJONI
Attorney at Law



- All Immigration Matters
- Federal Court
- Personal Injury
- Real Estate



401 Broadway, Suite 1111, New York, NY 10013 | Tel: 212.625.8333